



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.03-168**  
**04.05.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1389/1 datë 27.3.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1946/2 datë 4.5.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 14-të, mbajtur më 3.5.2023, miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës – vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), në mënyrë që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 2 mars 2023, nuk transmetoi së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, as edhe së paku gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që transmeton në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.  
Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1389/1 datë 27.3.2023, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.
2. DETYROHET që SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV.
3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryehet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.
4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë e miratimit të tij, llogaritet dita e vërtetimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV ka kompetenca të kryen kontroll programor (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar, lejeve, vërtetimeve të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera, miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – aktvendim për vërejtje publike në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV, dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në lejet dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 92 paragrafi (1) dhe (3) të LSHMAAV, Shoqërit Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive detyrohen gjatë ditës të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, ndërsa shërbimi publik radiodifuziv së paku 40%. Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv detyrohen që gjysmën e detyrimeve të përcaktuara në paragrafi (1) të këtij neni t'i realizojnë në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.

Në kuadër të kompetencave të saja ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 27 mars 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv ndaj SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, transmetuar më 2 mars 2023., në nivel shtetëror, nga ku konstatoi shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) nga LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja u konstatua se më 2 mars 2023, shërbimi programor televiziv i SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, ka transmetuar 4 orë 16 minuta dhe 54 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që është 19.93% nga totali i programit të transmetuar gjatë ditës i cila përfshihet në llogaritjen e programit të krijuar burimor (21 orë 28 minuta dhe 42 sekonda). Minimumi Ligjor prej 30% për transmetim program të krijuar burimor gjatë një dite, në raport me totalin e programit të transmetuar më 2 mars 2023. i cili përfshihet në llogaritjen e programit të krijuar burimor (21:28:42) është 6 orë 26 minuta dhe 36 sekonda. SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup ka transmetuar për 2 orë 9 minuta dhe 42 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase. Gjysma e minimumit Ligjor prej ( 06:26:36) është 3 orë 13 minuta dhe 18 sekonda program i krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonaseku, ku më së paku duhej të transmetohej në programin e SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, në periudhën nga ora 7:00 deri në orën 19:00. Në këtë periudhë, siç u konstatua nga mbikëqyrja, janë transmetuar 1 orë 52 minuta dhe 27 sekonda program i krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që në këtë situatë është për 1 orë 20 minuta dhe 51 sekonda më pak se minimumi i nevojshëm. Shkelja nga pika 1 i këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1389/1 datë 27.3.2023., që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup më 29.3.2023., dërgoi Shkresë me ark.nr.10-1389/2 datë 29.3.2023., ku i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me ark.nr.10-1389/1 datë 27.3.2023., me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklarament me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e radiodifuzerit më 6.4.2023. Në afatin e parashikuar, SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 3.5.2023., pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi ndaj SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup t'i shqipton masë-vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas Aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit me ark.nr.10-1389/1 datë 27.3.2023., për konstatimin e mosrespektim të dispozitave nga LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 14-të, mbajtur më 3.5.2023., në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-1946/2 datë 4.5.2023., miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmërohet SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup dhe detyrohet, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon veprimtarinë e tij me dispozitat nga LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti në fjalë, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) nga LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij Aktvendimi transmetuesi mund të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritje të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor aktvendim si në dispozitiv.

#### **Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me ark.nr.10-1389/1 datë 27.3.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritje të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.